Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit 27
Pasqyrat Financiare Individuale

Objektivi

1 Objektivi i këtij Standardi është të përshkruajë kërkesat lidhur me kontabilizimin dhe dhënien e informacioneve shpjeguese për investimet në filiale, sipërmarrjet e përbashkëta dhe pjesëmarrjet kur një njësi ekonomike përgatit pasqyra financiare individuale.

Objekti

2 Ky Standard do të zbatohet për kontabilizimin e investimeve në filiale, në sipërmarrje të përbashkëta dhe në pjesëmarrje kur njësia ekonomike zgjedh të paraqesë pasqyra financiare individuale ose kur kjo gjë i kërkohet nga rregullat lokale.

3 Ky Standard nuk ka detyrimin të përcaktojë se cilat njësi ekonomike duhet të hartojnë pasqyra financiare individuale. Ai zbatohet kur një njësi ekonomike përgatit pasqyra financiare individuale në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Përkufizimet

4 Termat e mëposhtëm janë përdorur në këtë Standard sipas këtyre kuptimeve specifike:

***Pasqyrat financiare të konsoliduara* janë pasqyrat financiare të një grupi në të cilin aktivet, detyrimet, kapitali neto, të ardhurat, shpenzimet dhe flukset e mjeteve monetare të shoqërisë mëmë dhe filialeve të saj janë paraqitur si të ishte një njësi ekonomike e vetme.**

Pasqyrat financiare individuale* janë ato të paraqitura nga një njësi ekonomike në të cilën njësia ekonomike mund të zgjedhë, në përputhje me kërkesat e këtij Standardi, të mbaj llogari për investimet e saj në filiale, sipërmarrje të përbashkëta dhe pjesëmarrjet ose me kosto, në përputhje me SNRF 9 *Instrumentet financiarë*, ose duke përdorur metoda e kapitalit neto, siç përshkruhet në SNK 28 *Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta.

5 Termat e mëposhtëm janë përcaktuar në Shtojcën A të SNRF 10 *Pasqyrat financiare të konsoliduara*, Shtojcën A të SNRF 11 *Marrëveshjet e përbashkëta* dhe paragrafin 3 të SNK 28:

- pjesëmarrje
- kontroll i një të investuari
- metoda e kapitalit neto
- grup
- njësi ekonomike investuese
- kontroll i përbashkët
- sipërmarrje e përbashkët
- sipërmarrës i përbashkët
- shoqëria mëmë
- influencë e konsiderueshme
- filial.

6 Pasqyrat financiare individuale janë pasqyra të tjera të paraqitura përvec atyre të konsoliduara ose pasqyrave financiare të një investitori i cili nuk ka investime në një filial por ka investime në pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkëta në të cilat investimi në pjesëmarrje ose sipërmarrjen e përbashkët, sipas kërkesave të SNK 28 duhet të trajtohet sipas metodës së kapitalit neto, me përjashtim të rrethanave të paraqitura në paragrafët 8–8A.

7 Gjithashtu, pasqyrat financiare të një njësie ekonomike që nuk ka filial, pjesëmarrje ose interes sipërmarrës të përbashkët në një sipërmarrje të përbashkët nuk janë pasqyra financiare individuale.

8 Një njësi ekonomike që përjashtohet nga konsolidimi në përputhje me paragrafin 4(a) të SNRF 10 ose që përjashtohet nga zbatimi i metodës së kapitalit në përputhje me paragrafin 17 të SNK 28 (i ndryshuar në 2011) mund të paraqesë pasqyrat financiare individuale si të vetmet pasqyra financiare.

8A Një njësi ekonomike investuese që i kërkohet, për të gjithë periudhën raportuese dhe për të gjitha periudhat krahasuese të paraqitura, të aplikojë përjashtimin nga konsolidimi për të gjitha filialet e saj në përputhje me paragrafin 31 të SNRF 10, paraqet pasqyra financiare individuale si pasqyrat e saj të vetme financiare.

Përgatitja e pasqyrave financiare individuale

9 Pasqyrat financiare individuale do të përgatiten në përputhje me të gjitha SNRF- të e zbatueshme, me përjashtim të kërkesave të paragrafit 10.

10 Kur një njësi ekonomike përgatit pasqyra financiare individuale, ajo do t'i trajtojë investimet në filial, sipërmarrje të përbashkëta dhe pjesëmarrje ose:

(a) me kosto;

(b) në përputhje me SNRF 9; ose

(c) duke përdorur metodën e kapitalit neto të paraqitur në SNK 28.

Njësia ekonomike do të zbatojë të njëjtin trajtim kontabël për çdo kategori të investimeve. Investimet e mbajtura me kosto ose sipas metodës së kapitalit neto duhet të kontabilizohen në përputhje me SNRF 5 *Aktivet afatgjata që mbahen për t'u shitur dhe operacionet jo të vijueshme* nëse klasifikohen si të mbajtura për shitje ose për t'u shpërndarë (ose janë përfshirë në një grup për nxjerrje nga përdorimi, që është klasifikuar si i mbajtur për shitje ose për t'u shpërndarë). Matja e investimeve që kontabilizohen sipas SNRF 9 nuk ndryshon në rrethana të tilla.

11 Nëse një njësi ekonomike zgjedh, në përputhje me paragrafin 18 të SNK 28 (ndryshuar në vitin 2011), të matë investimet e saj në një filial ose në sipërmarrje të përbashkët me vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humbjes në përputhje me SNRF 9, ajo do t'i trajtojë këto investime në pasqyrat financiare individuale të saj në të njëjtën mënyrë.

11A Në qoftë se një shoqëri mëmë i kërkohet në përputhje me paragrafin 31 të SNRF 10, të masë investimet e saj në një filial me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në përputhje me SNRF 9, ajo duhet gjithashtu të llogarisë investimet e saj në një filial në të njëjtën mënyrë në pasqyrat e saj financiare individuale.

11B Kur një shoqëri mëmë e cila pushon së qëni si njësi ekonomike investuese ose bëhet rishtas një njësi ekonomike investuese, do të llogarisë efektet e këtij ndryshimi që nga data në të cilin ndryshimi ka ndodhur si më poshtë:

(a) kur një njësi ekonomike pushon së qeni njësi ekonomike investuese, kjo njësi ekonomike duhet ta trajtojë një investim në një filial, në përputhje me paragrafin 10. Data e ndryshimit të statusit, do të konsiderohet si data e blerjes. Vlera e drejtë e filialit në datën e supozuar të blerjes, do të përfaqësojë pagesën e supozuar transferuar për trajtimin kontabël të investimit në përputhje me paragrafin 10.

(i) [fshirë]

(ii) [fshirë]

(b) kur një njësi ekonomike bëhet rishtazi njësi ekonomike investuese do të kontabilizojë një investim në një filial me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, në përputhje me SNRF 9. Diferenca midis vlerës kontabël (neto) të mëparshme të filialit dhe vlerës së drejtë të tij në datën e ndryshimit të statusit të investitorit do të njihet si fitim ose humbje. Shuma e akumuluar e ndonjë rregullimi të vlerës së drejtë që më parë është njohur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse dhe që i përkasin këtyre filialeve do të trajtohen sikur njësia ekonomike investuese t'i kishte shitur këto filiale në datën e ndryshimit të statusit.

12 Një njësi ekonomike duhet të njohë një dividend nga një filial, sipërmarrje e përbashkët ose pjesëmarrje në pasqyrat e saj financiare individuale nëse përcaktohet e drejta e saj për të arkëtuar dividendin. Dividendi njihet në fitim ose humbje me përjashtim të rastit kur njësia zgjedh të përdorë metodën e kapitalit neto. Në këtë rast dividendi njihet si pakësim i vlerës kontabël neto të investimit.

13 Kur një njësi ekonomike kontrolluese riorganizon strukturën e saj të grupit nëpërmjet krijimit të një njësie ekonomike të re si kontrolluese të saj në mënyrë që të plotësohen kërkesat në vijim:

 © Fondacioni i SNRF-ve

(a) njësia e re kontrolluese merr kontrollin nga njësia ekonomike kontrolluese e mëparshme nëpërmjet emetimit të instrumenteve të kapitalit në këmbim të instrumenteve ekzistues të kapitalit të njësisë ekonomike kontrolluese fillestare;

(b) aktivet dhe detyrimet e grupit të ri dhe të grupit fillestar janë të njëjtë menjëherë para dhe pas riorganizimit; dhe

(c) pronarët e njësisë ekonomike kontrolluese fillestare para riorganizimit zotërojnë të njëjtat madhësi absolute dhe relative interesi mbi aktivet neto të grupit fillestar dhe të grupit të ri menjëherë para dhe pas riorganizimit

dhe njësia ekonomike kontrolluese e re, në pasqyrat financiare të saj i kontabilizon investimet e saj në njësinë ekonomike kontrolluese fillestare në përputhje me paragrafin 10(a), njësia ekonomike e re kontrolluese do të matë koston e investimit me vlerën kontabël të aksioneve të saj në zërat e kapitalit të vet të pasqyrave financiare individuale të njësisë ekonomike kontrolluese fillestare në datën e riorganizimit

14 Në mënyrë të ngjashme, një njësi ekonomike që nuk është njësi kontrolluese mund të krijojë një njësi ekonomike të re si kontrolluese të saj në një mënyrë që plotëson kërkesat e paragrafit 13. Kërkesat në paragrafin 13 zbatohen njëlloj edhe për këto riorganizime. Në raste të tilla termat 'njësia kontrolluese fillestare' dhe 'grupi fillestar' i referohen 'njësisë ekonomike fillestare'.

Dhënia e informacioneve shpjeguese

15 Njësia ekonomike do të zbatojë të gjitha SNRF-të përkatëse kur ajo jep informacione shpjeguese në pasqyrat financiare individuale të saj, përfshirë kërkesat në paragrafët 16-17.

16 Kur një njësi ekonomike kontrolluese në përputhje me paragrafin 4(a) të SNRF 10, zgjedh të mos përgatitë pasqyra financiare të konsoliduara dhe në vend të tyre përgatit pasqyra financiare individuale, ajo do të japë informacione shpjeguese në këto pasqyra për:

(a) faktin që pasqyrat financiare janë pasqyra financiare individuale; që është përdorur përjashtimi nga konsolidimi; emrin dhe vendin kryesor i biznesit (dhe shteti ku është regjistruar nëse është i ndryshëm) i njësisë ekonomike, pasqyrat financiare të konsoliduara të së cilës, që janë sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, kanë qenë hartuar për përdorim publik; dhe adresa ku mund të merren këto pasqyra financiare individuale.

(b) një listë të investimeve të rëndësishme në filiale, sipërmarrje të përbashkëta dhe pjesëmarrje, përfshirë:

(i) emrin e këtyre investimeve.

(ii) vendin kryesor të biznesit (dhe shtetin ku është regjistruar nëse është i ndryshëm) të këtyre investimeve.

(iii) pjesën e saj të interesave të zotëruar (dhe pjesën e saj të të drejtave për të votuar, nëse janë të ndryshme) në këto investime.

(c) një përshkrim të metodës së përdorur për të kontabilizuar investimet e listuara në pikën (b).

16A Kur një njësi ekonomike investuese që është shoqëri mëmë (e ndryshme nga një shoqëri mëmë që mbulohet nga paragrafi 16) paraqet, në përputhje me paragrafin 8A, pasqyra financiare individuale si të vetmet pasqyra financiare të saj, ajo do të japë informacion shtesë rreth këtij fakti. Njësia ekonomike investuese do të japë gjithashtu informacione shpjeguese në lidhje me njësinë ekonomike investuese që kërkohen nga SNRF 12 *Dhënia e informacionit shpjegues mbi interesat në njësitë e tjera ekonomike.*

17 Kur një shoqëri mëmë (e ndryshme nga një shoqëri mëmë që mbulohet nga paragrafi 16-16A) ose një investitor me kontroll të përbashkët, ose influencë të konsiderueshme mbi një të investuar që paraqet pasqyra financiare individuale, mëma ose investitori duhet të identifikojnë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me cilën prej SNRF 10, SNRF 11, ose SNK 28 (të ndryshuara në 2011). Mëma ose investitori do të japë gjithashtu informacione shpjeguese në pasqyrat e tij financiare individuale:

(a) faktin që pasqyrat janë pasqyra financiare individuale dhe arsyet pse janë përgatitur këto pasqyra nëse kjo nuk kërkohet nga ligji.

(b) një listë të investimeve të rëndësishme në filiale, sipërmarrje të përbashkëta dhe pjesëmarrje, përfshirë:

(i) emrin e këtyre investimeve.

(ii) vendin kryesor të biznesit (dhe shtetin ku është regjistruar nëse është i ndryshëm) të këtyre investimeve.

(iii) pjesën e saj të interesave të zotëruar (dhe pjesën e saj të të drejtave për të votuar, nëse janë të ndryshme) në këto investime.

(c) një përshkrim të metodës së përdorur për të kontabilizuar investimet e listuara në pikën (b).

Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare

18 Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë Standard për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2013 e në vijim. Lejohet aplikimi më i hershëm. Nëse një njësi ekonomike e zbaton këtë SNRF përpara datës, ajo do të japë informacion shpjegues për këtë fakt dhe do të zbatojë në të njëjtën kohë SNRF 10, SNRF 11, SNRF 12 dhe SNK 28 (të ndryshuar në 2011).

18A *Njësitë ekonomike investuese* (ndryshime për SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 27), publikuar në tetor 2012, ka ndryshuar paragrafët 5,6,17, dhe 18, dhe ka shtuar paragrafët 8A, 11A-11B, 16A dhe 18B-18I. Një njësi ekonomike do të aplikojë këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas datës 1 janar 2014. Lejohet aplikimi më i hershëm. Në qoftë se një njësi ekonomike aplikon më herët këto ndryshime, ajo duhet të japë informacion shtesë për këtë fakt dhe të aplikojë të gjitha ndryshimet e përfshira në *Njësitë ekonomike investuese* në të njëjtën kohë.

18B Në qoftë se, në datën e aplikimit fillestar të ndryshimeve të *Njësitë ekonomike investuese* (e cila për qëllime të kësaj SNRF, është fillimi i periudhës raportuese për të cilën këto ndryshime janë aplikuar për herë të parë), një shoqëri mëmë arrin ne konkluzionin që ajo është një njësi ekonomike investuese, ajo duhet te aplikojë paragrafët 18C-18I për investimet e saj në një filial.

18C Në datën e aplikimit fillestar, një njësi ekonomike investuese që më parë ka matur investimet e saj në një filial me kosto duhet që në fakt ta masë këtë investim me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes sikur kërkesat e kësaj SNRF të ishin efektive gjatë gjithë kohës. Njësia ekonomike investuese duhet që në mënyrë retrospektive të rregullojë si periudhën vjetore më të afërt që paraprin datën e aplikimit fillestar, ashtu dhe fitimet e pa shpërndara në fillim të periudhës më të afërt që i paraprin për çdo diferencë midis:

(a) vlerës së mëparshme kontabël të investimit; dhe

(b) vlerës së drejtë të investimit që investitori ka bërë në filial.

18D Në datën e aplikimit fillestar, një njësi ekonomike investuese që më parë ka matur investimet e sajë në një filial me vlerën e drejtë të paraqitur në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse do të vazhdojë të masë këtë investim më vlerën e drejtë. Shuma e akumuluar e ndonjë rregullimi të mëparshëm i njohur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse duhet të transferohet tek fitime të pa shpërndara në fillim të periudhës vjetore që i paraprin datës së aplikimit.

18E Në datën e aplikimit fillestar, një njësi ekonomike investuese nuk do të bëjë rregullime të kontabilizimeve të mëparshme për një interes në një filial që më parë kishte zgjedhur ta maste me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në përputhje me SNRF 9, siç e lejon paragrafi 10.

18F Përpara datës së adoptimit të SNRF 13 *Matja me vlerën e drejtë,* një njësi ekonomike investuese duhet të përdorë shumat e vlerës së drejtë që më parë janë raportuar tek investitorët ose tek drejtuesit, në qoftë se këto shuma përfaqësojnë shumat për të cilat investimi mund të ishte këmbyer midis palëve të vullnetshme në një transaksion midis palëve të palidhura, në datën e vlerësimit.

18G Në qoftë se matja e një investimi në një filial në përputhje me paragrafët 18C-18F është praktikisht e pa mundur (siç përcaktohet në SNK 8 *Politikat kontabël, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet*), [1] një njësi ekonomike investuese duhet të aplikojë kërkesat e kësaj SNRF në fillim të periudhës më të hershme për të cilën aplikimi i paragrafëve 18C-18F është i praktikueshëm, e cila mund të jetë dhe periudha aktuale. Investitori në mënyrë retrospektive do të rregullojë periudhën vjetore më të afërt që i paraprin datës së aplikimit fillestar, përveç rastit kur fillimi i periudhës më të hershme për të cilën aplikimi i këtij paragrafi është praktikisht i mundshëm përkon me periudhën aktuale. Data kur për njësinë ekonomike investuese është e mundshme të masë vlerën e drejtë të filialit është më e hershme se fillimi i periudhës më të hershme pararendëse, investitori do të rregullojë kapitalin neto në fillim të periudhës më të hershme pararendëse për çdo diference midis:

[1] Kur publikoi SNRF 18 *Paraqitja dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese në Pasqyrat Financiare* në prill 2024, BSNK ndryshoi titullin e SNK 8 në *Baza e Përgatitjes së Pasqyrave Financiare*.

 © Fondacioni i SNRF-ve

(a) vlerës së mëparshme kontabël të investimit; dhe

(b) vlerës së drejtë të investimit që investitori ka bërë në filial.

Në qoftë se periudha më e hershme për të cilën aplikimi i këtij paragrafi është i mundshëm është periudha aktuale, rregullimi i kapitalit neto do të njihet në fillim të periudhës aktuale.

18H Në qoftë se një njësi ekonomike investuese, ka shitur ose ka humbur kontrollin e një investimi në një filial përpara datës së aplikimit fillestar të ndryshimeve të *Njësive ekonomike investuese*, njësisë ekonomike investuese nuk i kërkohet të bëjë rregullime të mënyrës së kontabilizimit të mëparshëm për këtë investim.

18I Pavarësisht referencës për periudhën vjetore që menjëherë i paraprin datës së aplikimit fillestar ('periudha më e hershme pararendëse') në paragrafët 18C-18G, një njësi ekonomike mundet gjithashtu të prezantojë informacion krahasues për çdo periudhë më të hershme të paraqitur, por kjo nuk i kërkohet. Në qoftë se një njësi ekonomike paraqet informacion krahasues të rregulluar për çdo periudhë më të hershme, të gjitha referencat për 'periudhën më të hershme pararendëse' në paragrafët 18C-18G duhet të lexohet si 'periudha më e hershme krahasuese e rregulluar'. Në qoftë se një njësi ekonomike prezanton informacion krahasues të pa rregulluar për ndonjë periudhë të më hershme, ajo do të identifikojë qartazi që informacioni nuk është i rregulluar, të deklarojë që informacioni është përgatitur mbi baza të ndryshme, dhe t'i shpjegojë këto baza.

18J *Metoda e kapitalit neto në pasqyrat financiare të veçanta* (Ndryshime në SNK 27), i publikuar në gusht 2014, ndryshoi paragrafët 4–7, 10, 11B dhe 12. Njësia ekonomike duhet t'i zbatojë këto ndryshime në mënyrë retrospektive, për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2016 ose më pas në përputhje me SNK 8 *Politikat kontabël, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet*.[2] Lejohet aplikimi më i hershëm. Nëse një njësi ekonomike i zbaton këto ndryshime për një periudhë më të hershme, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

Referencat në SNRF 9

19 Nëse një njësi ekonomike zbaton këtë Standard, por akoma ajo nuk ka zbatuar SNRF 9, çdo referencë ndaj SNRF 9 do të lexohet si referencë ndaj SNK 39 *Instrumentet financiarë: Njohja dhe matja.*

Tërheqja e SNK 27 (2008)

20 Ky Standard është publikuar njëkohësisht me SNRF 10. Së bashku, të dy SNRF-të zëvendësojnë SNK 27 *Pasqyrat financiare të konsoliduara dhe individuale* (ndryshuar në vitin 2008).

[2] Kur publikoi SNRF 18, BSNK ndryshoi titullin e SNK 8.